



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

Datë 26/11/2024

**PROCES VERBAL**

**Konsultimi Publik mbi Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2025**

**Vendi :** Qendra Kulturore Multifunktionale

**Ora :** 14:00

**Tema e konsultimit :** Buxheti dhe Paketa Fiskale 2025

I mbajtur sot më datë 26 Nëntor në ambientet e Qendrës Kulturore Multifunktionale Përmet me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë znj. Alma Hoxha, Kryetares së Këshillit Bashkiak znj. Anila Dhimitri, nën/Kryetarit z. Florand Hasani, Drejtoreshës së Buxhet-Financës znj. Etleva Kreci dhe gjithë stafit drejtues të Bashkisë Përmet. Gjithashtu të pranishëm janë biznese të ndryshme, restorante, hotele, operatorë turistikë dhe qytetarë të interesuar.

Takimin e hapi Kryetarja e Bashkisë znj. Alma Hoxha e cila si fillim përshëndeti dhe falenderoi të gjithë të pranishmit në sallë. Më pas ajo theksoi se këto takime janë mjaft të rëndësishme për hartimin e Buxhetit dhe Paketës Fiskale. Ajo tha se Paketa Fiskale do të jetë thuajse e pandryshuar me përjashtim të disa tarifave që janë shtuar në të. Gjithashtu znj. Hoxha tha se në fokus do të jenë përsëri shërbimet, më pas ajo mbylli fjalën e saj për të dëgjuar sugjerime dhe mendime nga të pranishmit.

Më pas fjalën e mori znj. Etleva Kreci e cila falenderoi të gjithë të pranishmit në sale pasi diskutimet sjellin përmirësim dhe synimi i Bashkisë është bashkëpunimi dhe mbështetja e biznesit vendas. Ajo tha gjithashtu tregoi se Paketa Fiskale do të pësojë vetëm pak ndryshime. Gjithashtu u tha se sugjerimet e dhëna nga viti i kaluar janë marrë parasysh njëjtë si do të veprohet me sugjerimet që do jepen sot.

Pas fjalës së saj, erdhi radha e pyetjeve nga të pranishmit që ishin si më poshtë :

- Si u vendos tarifa e pastrimit ?
- A janë evidentuar nga ana e Bashkisë të gjitha shtëpitë pritëse ?



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

- A janë të gjitha bizneset konform rregullave dhe ligjeve në fuqi ?
- Kur do të fillojë procesi i kategorizimi të mbetjeve sipas llojit ?

Pasi u dhanë përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe disa të tjerave, znj.Hoxha dhe znj.Kreci theksuan se nga ana e Bashkisë do të bëhet maksimumi për të luftuar konkurrencën e pandershme si dhe i ftoi të gjitha bizneset e qytetit të bashkëpunojnë sa më shumë për të ecur para.

Në fund të takimit Kryetarja e Bashkisë i falenderoi edhe një herë të gjithë pjesëmarrësit dhe u tha atyre se është e gatshme për të zhvilluar takime të tilla sa herë ata do të kenë nevojë.

**Konceptoi:**

**Koordinatori i Konsultimit Publik**

**Albion Naska**

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

**Denisa DURO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

**Foto nga takimi:**

